



## DESHMI TRASHEGIMIE LIGJORE

NOTERE: RITA HASA  
DHOMA E NOTERISE VLORE

AKSA E VUIJE  
U PAGUA

Sot më datë 02 Nentor 2015 ( dymije e pesëmbëdhjete ), ora 12.00, une notere Rita Hasa, anetare e Dhomes se Notereve Vlore, me zyre noteriale te ndodhur ne qytetin e Fierit ne adresen Lagjja " 29 Nentori ", Rruga " Todi Shkurta ", prane Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier, mora në shqyrtim kerkesen dhe dokumentacionin që i përket:

**KËRKUESE: MIRANDA TURHANAJ**, me atesi - Hysen dhe amesi - Lirije, e datelindjes 20.07.1966, lindur ne Fier, gjinia femer, me gjendje civile " e ve ", me shtetesi shqiptare, me adresen e banimit ne Qytetin e Fierit, Lagjja " 8 Shkurti ", Bashkia Fier, Qarku Fier, me nr. personal G65720026V, madhore dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**OBJEKTI: Lëshimin e dëshmisë së trashëgimise ligjore për trashëgimlënësin FIQIRI TURHANAJ**, me atesi - Qani dhe amesi - Lut, i datelindjes 08.08.1960, lindur ne Fier, gjinia mashkull, me gjendje civile " i martuar ", me shtetesi shqiptare, vendbanimi i fundit ne Qytetin e Fierit, Lagjja " 8 Shkurti ", Bashkia Fier, Qarku Fier, me nr. personal G00808056P, vdekur me date 05.10.2015

**BAZA LIGJORE:** Nenet 348 e vijues të Kodit Civil.

Në përfundim të shqyrtimit te kerkeses dhe dokumentacionit në prani të kërkueses MIRANDA TURHANAJ, e cila kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj, une noterja

### V Ë R E J

Se kërkuesja eshte bashkeshortja e te ndjerit FIQIRI TURHANAJ, ndaj në bazë të nenit 32 të Kodit të Procedurës Civile, ajo ka interes te ligjshëm në këtë gjykim, pra legjitimohet të paraqesë kërkimin para kësaj Zyre Noterie.

Gjithashtu zyra ime noteriale e ndodhur ne Qytetin e Fierit, në bazë të Kodit të Procedurës Civile, ka kompetencën tokësore për shqyrtimin e kërkesës, pasi vendbanimi i fundit i trashëgimlënësit rezulton të ketë qenë në Fier.

Në lidhje me pretendimin e kërkuesit, para noteres u shtruan për zgjidhje këto çështje:

1. përcaktimi i trashëgimtarëve të trashëgimlënësit FIQIRI TURHANAJ, të kërkuar nga kërkuesja;
2. pjesët takuese te secilit prej tyre.

Për të zgjidhur këto probleme, une noterja i referohem nenit 318 të Kodit Civil, i cili në lidhje me përcaktimin e trashëgimtarëve të trashëgimlënësit dhe pjesët takuese të secilit, bën të zbatueshëm **ligjin e kohës se çeljes së trashëgimisë**, referuar rregullimit ligjor në **kohën e vdekjes së trashëgimlënësit**.

Nga shqyrtimi i akteve rezultojnë se: më datë 05.10.2015 ka vdekur trashëgimlënësi FIQIRI TURHANAJ, fakt që vërtetohet nga çertifikata e tij e vdekjes lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Nr. 3 – Bashkia Fier ne date 12.10.2015.

Gjithashtu ne baze te kesaj certifikate **rezultojnë se i ndjeri ka qene me gjendjen civile “ i martuar “** .

Në rastin konkret ligji i zbatueshëm është ligji nr.7850 datë 29.7.1994 « Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë », dhe meqenëse nga hetimi nuk rezultojnë që trashëgimlënësi të ketë disponuar pasurinë e tij me testament, në bazë të nenit 317 te Kodit Civil do të zbatohet trashëgimia ligjore.

Neni 361 i Kodit Civil aktual, përcakton si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë bashkëshortin dhe fëmijët me formulimin: **«Në radhë te parë thirren në trashëgim fëmijët dhe bashkëshorti i aftë ose i paaftë për punë, duke trashëguar secili në pjesë të barabarta»**

Nga verifikimi i këtyre certifikatave : certifikates se përbërjes familjare me nr. 008011962+008011961 – date 21.10.2015 ( certifikate e perberjes familjare e viteve 1950 – 1974 ); certifikates se përbërjes familjare me nr. 008011960 – date 21.10.2015 ( certifikate e perberjes familjare e dates 31.12.1973 ); certifikates se përbërjes familjare me nr. 008502294 – date 12.10.2015 ( gjendja familjare nje dite para vdekjes se trashegimlenesit ) dhe certifikates se martesës; certifikata keto te leshuara nga Zyrat e Gjendjes Civile te Rrethit Fier, **rezultojnë se i ndjeri FIQIRI TURHANAJ ka qenë i martuar me shtetasen MIRANDA TURHANAJ dhe nga martesja e tyre u kanë lindur dy fëmijë, perkatesisht shtetasit ERGIS TURHANAJ dhe GRETA TURHANAJ.**

- Nga të gjitha certifikatat e administruara nga une noterja rezultojnë se bashkëshortja e trashëgimlënësit, shtetasja MIRANDA TURHANAJ dhe fëmijet e tij ERGIS TURHANAJ dhe GRETA TURHANAJ janë gjalle edhe sot, ndaj kanë qene gjalle ne kohen e vdekjes se trashegimlenesit dhe si te tillë ata përfshihen në rrethin e trashëgimtarëve ligjorë të radhës së parë të tij.
- Nga hetimi nuk rezultojnë që trashëgimtarët e mësipërm të kenë hequr dorë nga trashëgimi, të jenë shpallur i padenjë për të trashëguar me vendim gjykatë, apo të jenë përjashtuar nga trashëgimia .
- Gjithashtu nuk rezultojnë që trashëgimlënësi të ketë pasur martesë të mëparshme, as të ketë pasur fëmijë të tjerë jashtë martesës, apo të birësuar.
- Kerkuesja me deklaroi se nuk ka trashëgimtare te tjere ligjore, pervec atyre te pasqyruar ne trungun familjar dhe ne certifikatat e lindjeve te depozituara prej saj.

Për sa më sipër, trashëgimtarë ligjorë të trashëgimlënësit FIQIRI TURHANAJ janë bashkeshortja MIRANDA TURHANAJ dhe femijet e tij ERGIS TURHANAJ dhe GRETA TURHANAJ, të cilët e trashëgojnë atë në 1/3 ( një te tretën ) pjesë të pasurisë trashëgimore dhe mbartin detyrimet e tij në të njëjtën masë.

Shpenzimet noteriale të përcaktuara nga urdheri Nr. 306 datë 31.07.2013, janë në ngarkim të kërkuesses dhe përbëhen nga ato për paraqitjen e kërkesës dhe leshimin e trashëgimisë ligjore.

### PËR KËTO ARSYE

Une notere RITA HASA në bazë të neneve 316, 317, 318, 348, 360, 361 të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë ( i ndryshuar ) dhe neneve 53, 53/1 e vijues të Ligjit nr. 131/2013 “ Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 7829 datë 01.06.1994 “ PER NOTERINE “ ( i ndryshuar ) “

### VENDOSA

Pranimin e kërkesës.

Lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin FIQIRI TURHANAJ, duke përcaktuar si trashëgimtare ligjore të radhës së pare:

1. **MIRANDA TURHANAJ - BASHKESHORTJA**, me atesi - Hysen dhe amesi - Lirije, e datelindjes 20.07.1966, lindur në Fier, gjinia femer, me gjendje civile “e ve”, me shtetësi shqiptare, me adresën e banimit në Qytetin e Fierit, Lagjja “ 8 Shkurti “, Bashkia Fier, Qarku Fier, me nr. personal G65720026V;
2. **ERGIS TURHANAJ - I BIRI**, me atesi - Fiqiri dhe amesi - Miranda, i datelindjes 31.10.1994, lindur në Fier, gjinia mashkull, me gjendje civile “ beqar “, me shtetësi shqiptare, me adresën e banimit në Qytetin e Fierit, Lagjja “ 8 Shkurti “, Bashkia Fier, Qarku Fier, me nr. personal J41031062V;
3. **GRETA TURHANAJ - E BIJA**, me atesi - Fiqiri dhe amesi - Miranda, e datelindjes 20.11.2004, lindur në Fier, gjinia femer, me gjendje civile “ beqare “, me shtetësi shqiptare, me adresën e banimit në Qytetin e Fierit, Lagjja “ 8 Shkurti “, Bashkia Fier, Qarku Fier, me nr. personal K46120052T;

të cilët e trashëgojnë trashëgimlënësin në 1/3 ( një te tretën ) pjesë të pasurisë trashëgimore secili, si dhe përgjigjen për detyrimet trashëgimore në të njëjtën masë.

U leshua në Fier, sot më datë 02.11. 2015

NOTERE

RITA HASA